



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.4.1-2013-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË ISTOGUT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2013

Prishtinë, Qershor 2014

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, ndërsa mund të ndër marr edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunitetit në Istogut në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri, i mbështetur nga, Mehmet Muçaj (Udhëheqës Ekipi), Qëndresa Sogojeva, Mexhit Ferati dhe Evetar Zeqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	7
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak	12
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	13
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	25
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	28

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të komunës së Istogut për vitin 2013 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2013 u ndërmorr në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit në Sektorit Publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Vjetore Financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, të datës 29.10.2013.

Auditimi ynë është fokusuar në:

- Pajtueshmërinë me kornizën e raportimi dhe rreziqet domethënëse për Pasqyrat Vjetore Financiare të theksuara në Memon e Planifikimit të Auditimit;
- Veprimet e ndërmarra ndaj rekomandimeve tona për vitin 2012 dhe atyre të mëhershme; dhe
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm të Komunës së Istogut (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit, dhe auditimin e brendshëm).

Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2013 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion

Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është i plotë dhe i saktë për arsye se ekzistojnë prona dhe objekte të komunës që nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk janë prezantuar në PVF. Projektet në shumë prej 447,842€ të cilat nuk janë përfshirë në PVF janë: Çerdhja e fëmijëve (261,165€), ndërtimi i trotuarëve (167,777€) dhe një veturë (18,900€). Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale') në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

(SNISA 200: Opinion i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

Konkluzioni i përgjithshëm

Bazuar në detajet e paraqitura në secilën pjesë të këtij raporti, konkluzioni ynë i përgjithshëm është se:

Menaxhmenti i Komunës nuk kishte arritur të ndërtoj një sistem efektiv të kontrollit të brendshëm dhe kontrollet aktuale të vendosura kishin funksionuar dobët gjatë vitit 2013. Në veçanti ne identifikuar:

- Edhe pse Pasqyrat Vjetore Financiare kishin adresuar shumicën e kërkesave për prezantim, Pasqyrat Vjetore Financiare të paraqitura për auditim kishin një numër lëshimesh dhe pasaktësish. Komuna i ka përmirësuar Pasqyrat Vjetore Financiare në versionin final, megjithatë disa zëra mbeten të pakorrigjuara nga menaxhmenti;
- Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare ishin regjistrimi jo i saktë i pasurive, ku ne identifikuar 447,842€ pasuri që nuk ishin përfshirë në regjistrin kontabël;
- Rekomandimet e vitit 2012 dhe të viteve të mëparshme nuk janë adresuar ende në tërësi. Kjo do të rezultojë në kontrolle të dobëta/vlerë të dobët për para/humbje potenciale financiare të vazhdueshme; dhe
- Edhe pse ne arritëm të merrnim siguri nga kontrollet efektive të menaxhmentit në disa fusha të pasqyrave, vlerësimi ynë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ka nxjerr në pah se në disa fusha të rëndësishme të veprimtarisë ekzistojnë mangësi të

theksuara në prokurim ku kontratat janë menaxhuar në nivel jo të kënaqshëm, dhe në mos themelimin e komitetit të auditimit si dhe auditimi i brendshëm nuk kishte arrit të identifikoj dobësitë e kontrolleve dhe t'i ofroj menaxhmentit nivelin e sigurisë rreth sistemeve kyçe financiare për vitin 2013.

Rekomandimet kryesore të Auditorit të Përgjithshëm janë si në vijim:

Kryetari duhet të sigurojë:

- Që në procesin e hartimit të Pasqyrave Vjetore Financiare për vitin 2014 të përfshihet formalisht edhe rishikimi nga menaxhmenti i draft pasqyrave me fokus të veçantë në fushat që konsiderohen me rrezik të lartë për gabime dhe/ose fushat ku gabimet janë identifikuar në vitet e mëparshme;
- Që plani i veprimit, i rishikuar, të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme;
- Se do të kryejë një vlerësim të detajuar të procesit të Prokurimit dhe kontrollit për të kuptuar arsyen pse dobësitë vazhdojnë të shfaqen dhe të identifikojë veprimet që duhen zbatuar për t'i adresuar këto dobësi;
- Se do të punojë me Njësinë e Auditimit të Brendshëm për të zhvilluar një plan të bazuar në rreziqe që do të ofronte siguri mbi të gjithat fushat e rëndësishme dhe shikoj mundësin e rritjes së stafit auditues të kësaj njësie; dhe
- Se do të rishikoj çështjen e themelimit të komitetit të auditimit në mënyrë që të fuqizoj rolin si dhe mbikëqyrjen e auditimit të brendshëm.

Përgjigja e Menaxhmentit – auditimi për vitin 2013

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha gjetjet e auditimit dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Komunës të përgatis Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar shkallën deri në të cilën mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale gjatë përcaktimit të testimit të hollësishëm, të cilat janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP) dhe fokusin e auditimit tonë.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe procedurat vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar. Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Konkluzioni i përgjithshëm

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Deklaratat kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Opinioni i Auditimit

Opinion i pamodifikuar¹ me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse ende nuk është i plotë dhe i saktë për arsye se ekzistojnë prona dhe objekte të komunës që nuk janë regjistruar në regjistrin kontabël dhe nuk janë prezantuar në PVF. Projektet në shumë prej 447,842€ të cilat nuk janë përfshirë në PVF janë: Çerdhja e fëmijëve (261,165€), ndërtimi i trotuarëve (167,777€) dhe një veturë (18,900€). Regjistri i pasurive fikse nuk ka ndikim në ndonjërin prej dy Pasqyrave Vjetore Financiare ('Pranimet dhe Pagesat në Para të Gatshme' dhe 'Krahasimi i Buxhetit me Shumat Aktuale') në pajtim me SNKSP në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme.

(SNISA 200: Opinioni i Pamodifikuar me Theksim të Çështjes).

¹ Termi "Opinion i Pamodifikuar" është ekuivalent me termin "opinion i pakualifikuar" i përdorur në versionin paraprak të Raportit Vjetor. Terminologjia e re është në pajtim me standardet e reja të INTOSAI-t (SNISA 200). Për më tutje referohuni në shtojcën I.

2.2 Rreziqet domethënëse në Pasqyrat Vjetore Financiare

Përshkrimi

Në Memon tonë të planifikimit të auditimit, të datës 29.10.2013, kemi identifikuar rreziqet domethënëse në PVF lidhur me plotësinë e pasurive, pagesat nga palët e treta si dhe prezantimin e saktë të pranimeve (të hyrave) në PVF.

Këto janë rreziqe të anomalive materiale, nga të cilat mund të rezultojë një opinion i modifikuar, përfshirë Theksimin e Çështjes.

Rreziku i planifikuar për prezantim të pranimeve dhe pagesave nga palët e treta në PVF nuk kishte ndodhur për faktin se komuna kishte ndërmarr veprimet e duhura në adresim të kësaj çështje.

Rreziqet e anomalive materiale që ne kemi identifikuar në lidhje me plotësinë e pasurive ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk kishte ndërmarr veprime për të adresuar rreziqet e identifikuar.

Rreziku i identifikuar

Çështja 1 - Pasuritë në pronësi të Komunës nuk ishin identifikuar dhe regjistruar në mënyrën e duhur, duke rezultuar kështu në anomali materiale në shënimet e pasurive në PVF

E gjetura

Ne kemi vlerësuar kontrollet e zbatuara nga menaxhmenti për ta dëshmuar plotësinë e të dhënave të pasurive në kontekst të shpenzimeve kapitale për vitin 2013 dhe vitet paraprake. Në memon e auditimit të ndërmjetëm, ne i kemi dhënë këshilla menaxhmentit për veprimin që nevojitet për të siguruar që shifra e pasurive në PVF të jetë e saktë. Megjithatë, rreziku i identifikuar është materializuar sepse Menaxhmenti nuk ka arritur të aplikojë përmirësimet e nevojshme në kontrollin e brendshëm. Vlera prej 10,556,261€ e prezantuar si pasuri në PVF nuk ishte e saktë sepse në të, përveç tokës, nuk ishin të përfshira edhe 447,842€, si çerdhja e fëmijëve (261,165€), ndërtimi i trotuarëve (167,777€) dhe një veturë (18,900€).

Rekomandimi 1 Prioritet i lartë - Kryetari i Komunës duhet të identifikoj arsyet për keq deklarimin fillestar të pasurive dhe dështimin për të ndjekur këshillat e ZAP. Procese të duhura duhet të vendosen në vitin 2014 për të siguruar se pasuritë komunale do të vlerësohen dhe të regjistrohen në regjistrat përkatës.

2.3 Pajtueshmëria me kërkesat për raportim në PVF

Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare (RrF) nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesën që PVF janë përgatitur brenda kornizës kohore dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave (MF);
- Kërkesën që PVF janë nënshkruar nga ZKA dhe ZKF;
- Kërkesën që PVF janë pranuar në gjuhën Shqipe dhe serbe;
- Kërkesën që PVF të jenë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Dorëzimin e raporteve të rregullta tremujore te Kuvendi Komunal dhe Ministri i Financave gjatë vitit 2013.

Kërkesat e mësipërme ishin plotësuar, përveç obligimit që ato të përgatiten edhe në gjuhën serbe.

PVF fillestare kanë përmbajtur disa gabime. Gjatë auditimit ne i kemi dhënë sugjerime menaxhmentit të komunës që të bëj korrigjimet e duhura, mirëpo në versionin final kemi vërejtur se korrigjimet në tërësi nuk ishin bërë nga ana e menaxhmentit, mangësitë e të cilave po i paraqesim më poshtë.

Çështja 2 Procesi i përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare – Prioritet i Lartë

E gjetura Në shënimin 30 regjistri i pasurisë nuk është i saktë për faktin që disa pasuri nuk ishin regjistruar në regjistrin kontabël. Vlera e pasurive të identifikuar të cilat nuk ishin të regjistruara ishte 447,842€. Për më gjërësisht, shih seksionin 2.2 të këtij raporti.

Shënimin 34- llogaritë e arkëtueshme ishin të nënvlerësuara për 5,584€.

Rreziku Pasqyrat vjetore financiare nuk janë të plota, sidomos për pjesën e pasurive dhe llogarive të arkëtueshme. Regjistrat e kontabilitetit janë të pamjaftueshëm për të mbështetur vendimin e menaxhmentit për të bërë proceset dhe konsideratat e gjëra buxhetore.

Rekomandimi 2 Kryetari duhet të sigurojë që plani i prodhimit të llogarive(PVF) për vitin 2014 formalisht adreson të gjitha kërkesat për pajtueshmëri lidhur me PVF-të, me fokus të veçantë në fushat e theksuara më lartë. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF lidhur me saktësinë e PVF-ve nuk duhet të dorëzohet pa u siguruar se janë zbatuar të gjitha kontrollet relevante para se ato t'i jenë dorëzuar Qeverisë.

2.4 Pajtueshmëria me kërkesat e tjera për raportim të jashtëm

Përshkrim

Përveç hartimit të PVF-ve, nga Kryetari kërkohet të adresojë obligimet për raportim të jashtëm si në vijim:

- Kërkesa Buxhetore;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Draft plani i prokurimit; dhe
- Raportet mbi borxhet.

Kërkesat e mësipërme ishin plotësuar, por komuna nuk kishte hartuar planin për adresimin e rekomandimeve të dhëna nga AP si dhe nuk kishte nxjerr raportin e vetëvlerësimit.

Rekomandimi 3 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se të gjitha kërkesat për raportim të jashtëm janë përmbushë në mënyrë cilësore dhe brenda afateve kohore të përcaktuara.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Menaxhmenti i komunës nuk kishte trajtuar në nivel të mjaftueshëm adresimin e rekomandimeve në raportin e auditimit për PVF-të e vitit 2012. Kjo ka shkaktuar që pjesa më e madhe e problemeve të përsëriten edhe në këtë vit.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të të vitit 2012 kishte rezultuar me 14 rekomandime. Komuna nuk kishte përgatitur Plan Veprimi për të adresuar rekomandimet e dhëna nga ZAP.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2013, pesë rekomandime ishin adresuar plotësisht; dy ishin trajtuar pjesërisht, dhe shtatë nuk ishin adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 3 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak - Prioritet i lartë

E gjetura Vetëm një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar janë adresuar sepse Komuna nuk ka zbatuar ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e adresimit të rekomandimeve të dhëna nga AP. Menaxhmenti i komunës ishte i obliguar që një Plan veprimi ta dorëzoi në ZAP brenda 30 ditësh nga data e publikimit të raportit, por ky plan nuk është dorëzuar.

Rreziku Mos adresimi i rekomandimeve në formë të plotë tregon se në disa fusha vazhdojnë të ekzistojnë problemet e njëjta nga viti 2012, si dhe të përsëriten rekomandimet e vitit të kaluar. Dobësitë në fushën e prokurimit, pagesat e pa rregullta dhe vlerësimi i pasurive (tokat) po përsëriten në mënyrë sistematike dhe kjo rrit rrezikun për humbje financiare të komunës.

Rekomandimi 4 Kryetari i Komunës duhet të hartoj një plan për adresimin e rekomandimeve dhe të diskutoj me stafin përgjegjës për mënyrën se si të adresohen rekomandimet e dhëna, të caktoj një afat kohor optimal, të zbatueshëm dhe të fokusohet në fusha të rëndësishme më të madhe (apo fushat me prioritet).

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Konkluzioni i përgjithshëm

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv dhe rezultate nga këto veprime. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, por nuk ishin aq sa duhet funksionale. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, duke përfshirë rolin e ndërmarrë nga Auditimi i Brendshëm.

Ne kemi gjetur se kontrollet mbi procesin e planifikimit të të hyrave nuk janë të mira dhe nuk janë analizuar në mënyrë të qëndrueshme, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm në mënyrë që të parandalojë që komuna të ketë humbje financiare, vlerë të dobët për paranë dhe menaxhim jo efektiv të projekteve. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë, planifikimi i të hyrave, procesi i prokurimit, monitorimi i subvencioneve, regjistrimi i pasurisë, dhe përkushtimi më i madh në realizim të planit të auditimit dhe funksionalizimin e komitetit të auditimit të brendshëm.

4.2 Qeverisja e mirë

Raportimi financiar i brendshëm në kuadër të komunës është i rregulluar me kornizën ligjore në fuqi. Dobësitë në kontrollet e nivelit të lartë të identifikuar nga AP sugjerojnë se menaxhmenti do duhej të ndërmerr një qasje më proaktive të adresimit të këtyre çështjeve.

Çështja 4- Dobësi në kontrollet e menaxhmentit të lartë - Prioritet i lartë

- E gjetura** Auditimi i vitit 2013 ka identifikuar dobësi në kontrolle në të gjitha kategoritë ekonomike, veçanërisht në periudhën e fund vitit. Këto dobësi nuk ishin identifikuar në mënyrë efektive përmes mbikëqyrjes së brendshme dhe raportuar tek menaxhmenti, apo ku ato ishin identifikuar, nuk ishin marrë veprimet e duhura.
- Rreziku** Dobësitë në funksionimin e kontrolleve menaxheriale në sistemin financiar dhe koncentrimi i shpenzimeve në fund vit, reduktojnë aftësitë e menaxhmentit për të menaxhuar në mënyrë aktive aktivitetet e komunës dhe redukton kontrollin efektiv buxhetor.
- Rekomandimi 5** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se një strukturë e përshtatshme qeverisëse është zbatuar përmes së cilës menaxhmenti i lartë është i informuar për mangësitë e kontrollit dhe në mënyrë aktive i menaxhon ato. Ky proces duhet të mbështetet me dorëzimin e vetëvlerësimit të kërkuar nga MF.

4.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Përshkrimi

Në kemi shqyrtuar burimin e fondeve buxhetore për Komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – shpenzimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2013 Shpenzimi	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	8,386,727	8,683,582	8,339,097	7,855,664	7,272,733
Granti i Qeverisë -Buxheti	7,486,727	7,486,727	7,406,811	6,988,068	6,482,713
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	168,280	144,464	233,888	178,714
Të hyrat vetanake ⁴	900,000	900,000	683,436	608,049	561,334
Donacionet e brendshme	-	50,386	48,789	24,909	23,767
Donacionet e jashtme	-	78,189	55,597	750	26,205

Buxheti final, krahasuar me buxhetin fillestar, është më i lartë për 296,855€. Kjo rritje është rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak, për 168,280€ dhe donacioneve prej 128,575€.

Në vitin 2013, Komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 8,339,097€, që krahasuar me vitin 2012 paraqet nivel të njëjtë të ekzekutimit. Ekzekutimi i buxhetit, marrë në përgjithësi, është kontrolluar mirë dhe paraqet një performancë të kënaqshme.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetanake të Komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

⁴ Të hyrat komunale të planifikuara dhe të mbledhura në vitin aktual.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- shpenzimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Realizimi	2012 Realizimi	2011 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	8,386,727	8,683,582	8,339,097	7,855,664	7,272,733
Pagat dhe Mëditjet	4,366,810	4,366,810	4,318,168	4,272,524	4,133,180
Mallrat dhe Shërbimet	871,138	890,847	864,385	1,019,243	600,535
Shërbimet komunale	164,920	188,130	187,559	149,952	130,254
Subvencionet dhe Transferet	450,000	459,000	359,903	322,123	96,541
Investimet Kapitale	2,533,859	2,778,795	2,609,082	2,091,822	2,312,223

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

Derisa niveli i shpenzimeve për mallra dhe shërbime kishte një rënie prej 18% krahasuar me vitin e kaluar, e kundërta kishte ndodhë me investimet kapitale të cilat ishin rritur për 25%. Kjo është një tregues inkurajues se komuna është orientuar më shumë në projekte kapitale dhe ka përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve. Megjithatë, në vitin e ardhshëm përmirësimet e performancës edhe më tutje duhet fokusuar tek investimet kapitale dhe subvencionet dhe transferet, të cilat gjatë vitit 2013 ishin shpenzuar në shkallë relativisht të ultë (78%).

Asnjë vit, të hyrat vetjake nuk shpenzohen si rezultat direkt i mos ekzekutimit të buxhetit duke pasur parasysh se të hyrat vetanake janë burimi i fundit financiar i përdorur. Në vitin 2014 vlera e bartur e të hyrave ka qenë rreth 189,000€.

Kategoritë tjera buxhetore ishin shpenzuar brenda parametrave të planifikuar.

Tabela 3. Të hyrat vetjake komunale të buxhetuara dhe të mbledhura për vitin 2013 (në euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2013 Pranimet	2012 Pranimet	2011 Pranimet
Të hyrat vetanake	900,000	900,000	848,542	764,843	809,189

Buxheti fillestar për të hyrat vetanake nuk pasqyrore pranimet e vitit të kaluar dhe faktorët e tjerë relevant. Nga tabela shihet se realizimi i të hyrave ishte mjaft i lartë (94%). Në krahasim me vitin paraprak, të hyrat e planifikuara ishin mbi €80,000 apo 11% më të larta.

Ne kemi vërejtur se nuk ka një korrelacion të afërt në mes planifikimit dhe nivelit të faturimeve për tatimin në pronë. Komuna kishte planifikuar të inkasoj nga ky burim 260,000€, ndërsa kishte faturuar mbi 300,000€.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)

Përshkrimi

Komuna grumbullon disa lloje të të hyrave e më të rëndësishmet janë ato nga tatimi në pronë, lejet e ndërimit, taksat administrative, të hyrat nga qiraja, etj.

Komuna në përgjithësi ka vendosur deri në një masë kontrollë mbi regjistrimin dhe raportimin e të hyrave, megjithatë ka nevojë për përmirësime të mëtutjeshme në aplikimin e politikave dhe mekanizmave adekuat në mbledhjen e borxheve të mbetura nga vitet paraprake.

Çështja 5 - Planifikim jo i mirë i të hyrave nga tatimi në pronë - Prioritet i lartë

E gjetura Komuna kishte planifikuar të hyra nga tatimi në pronë në shumë prej 260,000€ dhe kishte inkasuar 270,935€ derisa faturimin për vitin 2013 e kishte bërë në shumë prej 300,676€.

Rreziku Nuk ka konsistencë të mjaftueshme në planifikimin e të hyrave. Plani fillestar për të hyrat nga tatimi në pronë ishte më i ultë për 15% sesa shumat e faturuara. Së këndejmi, shkalla e tejkalar e planit nuk paraqet performancën reale për të hyrat. Në anën tjetër, borxhet e pa mbledhura nga llogaria e tatimit në pronë tejkalojnë shifrën prej 800,000€. Kjo ndikon në bilancet e përgjithshme të komunës, me ndikimin final që projektet e planifikuara nga ky burim të dështojnë të realizohen.

Rekomandimi 6 Kryetari i Komunës duhet të shfrytëzoj burimet relevante të informatave para se ta aprovoj planin e të hyrave vetjake, si: trendi i inkasimeve nga vitet paraprake, baza ekonomike e taksapaguesve dhe fuqia e tyre paguese.

Çështja 6 - Dhënia e lejeve të ndërtimit në kundërshtim me kërkesat ligjore-Prioritet i mesëm

- E gjetura** Të hyrat e planifikuara nga kjo kategori ishin 105,000€, ndërsa realizimi 129,950€. Gjatë testimit kemi vërejtur se komuna kishte dhënë lejet e ndërtimit pa e mbledhur taksën e përlllogaritur. Kjo mënyrë e dhënies së lejeve të ndërtimit është në kundërshtim me ligjin e ndërtimit, respektivisht me nenin 21 pika 3 të ligjit të ndërtimit ku pala (aplikuesi) së pari duhet të ofroj dëshminë për pagesën e taksës së përcaktuar nga komuna, e pastaj t'i lëshohet leja.
- Rreziku** Dhënia e lejeve të ndërtimit pa kryer obligimin financiar ndaj komunës përveç që është në kundërshtim me ligjin e ndërtimit, shoqërohet me rrezikun që taksat e ndërtimit të mos inkasohen, dhe kanë ndikim negativ në bilancet buxhetore të komunës.
- Rekomandimi 7** Kryetari i Komunës duhet të rishikoj procedurat e dhënies së lejeve ndërtimore dhe të siguroj se taksat ndërtimore paguhen para se leja të lëshohet.

4.5 Shpenzimet

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Gjatë vitit 2013 përmes prokurimit investime kapitale dhe mallra dhe shërbime ishin shpenzuar 3,473,466€. Ne kemi testuar pesë lëndë të prokurimit në vlerë 512,658€ dhe 16 pagesa në vlerë prej 547,656€.

Auditimi ynë ka identifikuar disa dobësi në procesin e prokurimit mbi të cilat kontrollet nuk ishin zbatuar në mënyrë efektive.

Ne kemi verifikuar nëse projektet për investime kapitale kanë qenë të përfshira në Programin për Investime Publike (PIP) dhe në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Gjithashtu kemi rishikuar nëse ka ndodhur ndonjë ndryshim gjatë vitit lidhur me projektet e parapara që realizohen gjatë vitit. Nuk kemi ndonjë çështje lidhur me këto për të ngritur në këtë raport.

Çështja 7 - Dhënie e kontratave operatorëve ekonomik të pa përgjegjshëm - Prioritet i lartë

Në katër raste kemi identifikuar se komuna kishte zhvilluar procedurat e prokurimit në mungesë të Operatorëve Ekonomik (OE) të përgjegjshëm. Rastet e tilla ishin te kontratat e më poshtme:

- a. "Furnizim me medikamente, material stomatologjik dhe laborator për nevoja të QKMF-së" me çmim për njësi, Kompania fituese kishte ofruar Licencën e qarkullimit farmaceutik me shumicë me afat të skaduar;
- b. "Mirëmbajtja e rrugëve malore në shumë 9,990€, kompanisë fituese i mungonte kërkesa për përshtatshmëri profesionale;
- c. "Asfaltimi i Rrugës Lagja Ali Hajdaraj" në Istog në vlerë 64,227€, kompanisë fituese i mungonin dokumentet e noterizuara; dhe
- d. "Furnizim me dru për ngrohje për institucione komunale" me çmim për njësi, kompania fituese nuk kishte ofruar çmimin për njërin nga dy pozicionet e specifikacionit teknik.

Rreziku Shpërblimi me kontratë OE të pa përgjegjshëm rritë rrezikun që produktet të mos jenë të kualitetit të pritur dhe detyrimet kontraktuale të mos përmbushen. Po ashtu, zhvillimi i procedurave në mungesë të numrit minimal të operatorëve të përgjegjshëm është në kundërshtim me parimet kyçe të prokurimit publik dhe nuk siguron se nga konkurrenca është përzgjedhë ofertuesi më i volitshëm.

Rekomandimi 8 Kryetari i Komunës të siguroj që asnjë operator ekonomik nuk do të shpërblehet me kontratë nëse është i papërgjegjshëm dhe aty ku kontrollet nuk janë aplikuar, të përcaktohen arsyet dhe përgjegjësia të adresohet tek personat përgjegjës.

Çështja 8 - Pagesë për punët e pa përfunduara- Prioritet i lartë

- E gjetura** Pagesa për projektin “Rregullimi i trotuarëve dhe shtegut të biciklistëve Istog-Gurakoc” në vlerë 167,777€ ishte bërë e plotë derisa punimet nuk ishin kryer plotësisht. Ne me datën 12.05.2014 identifikuam që pozicioni i ndriçimit i paguar me datën 19.12.2013 në vlerë 7,423€, nuk ishte kryer derisa komuna (komisioni i pranimit teknik) kishin aprovuar si të përfunduar projektin. Ne informuam Kryetarin e Komunës për mangësitë e identifikuara në ekzekutimin e projektit, dhe pas kësaj, ai kishte marr masa duke eliminuar mangësitë e cekura më lartë.
- Rreziku** Menaxhimi i kontratës është përcjellë me mangësi. Pagesat e tilla nuk janë në pajtim me rregullat financiare mbi shpenzimin e parave publike dhe kryerja e pagesave para se punimet e kontraktuara të jenë kryer, rritë rrezikun që projektet të mos përfundohen apo të kenë kosto shtesë.
- Rekomandimi 9** Kryetari i Komunës duhet ta rishqyrtojë rastin dhe të përcaktoj pse dështimet në proces kanë ndodhur, shtoj kontrollet monitoruese për të siguruar se situata të tilla nuk do të përsëriten në të ardhmen dhe ndërmerri masa administrative aty ku nevojiten.

4.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollet që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) kontrollin e pagesave çdo muaj duke i nënshkruar listën e pagave b) verifikimin e ndryshimeve të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve, c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam 45 mostra ku rishikuam pajtueshmërinë e listave të pagave me sistemin e payrollit në Ministrinë e Administratës Publike, po ashtu kemi shikuar se pozitat e zyrtarëve dhe koeficientet a janë në pajtueshmëri me formën e sistemit të payrollit dhe listës së pagave.

Nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur lidhur me këtë..

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Komuna për subvencione dhe transfere kishte planifikuar buxhetin 459,000€ ndërsa kishte shpenzuar 359,903€. Ne kemi testuar 16 mostra në shumë 128,097€ apo 36%.

Planifikimi i subvencioneve dhe transfereve duhet të përmirësohet për të mos u shfaqur suficitet e larta si në vitin raportues, ku 22% të buxhetit për subvencione nuk ishte shpenzuar.

Komuna nuk kishte zbatuar rekomandimin e vitit të kaluar lidhur me hartimin e një rregulloreje të brendshme e cila do të përcaktonte kriteret për dhënie të subvencioneve dhe kërkesat për raportim për mënyrën e shpenzimit të mjeteve të përfituara. Dokumentet përcjellëse nuk ishin të strukturuar mirë.

Çështja 9 - Mos aprovim i Rregullores së brendshme për ndarjen e subvencioneve - Prioritet i mesëm

E gjetura Përkundër rekomandimeve tona të mëhershme, Komuna nuk kishte hartuar rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve, prandaj subvencionet ishin dhënë me vendim të Kryetarit të Komunës. Nga nëntë rastet e testuar, katër 4 prej tyre nuk kishin ofruar dokumente/raporte relevante për të justifikuar se shpenzimet kanë arritur qëllimin.

Rreziku Nuk është e sigurt nëse shpenzimet e planifikuara për subvencione dhe transfere kanë arritur qëllimin. Mungesa e politikave/rregulloreve të brendshme, reflekton mangësinë e procedurave që duhet ndiqen me rastin e subvencionimeve.

Rekomandimi 10 Kryetari i Komunës duhet që pa vonesë të inicoj për miratim në Kuvend Komunal një Rregullore që specifikon qartë kriteret, formën e raportimit dhe burimet e subvencioneve. Gjithashtu, planifikimi më i mirë dhe zbatimi i buxhetit sipas ndarjeve fillestare, duhet të jetë objektiv i përhershëm i menaxhmentit.

4.6 Pasuritë dhe detyrimet

4.6.1 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Komuna nuk kishte nxjerr dhe aplikuar ndonjë politikë adekuate në mbledhjen e borxheve të mbetura nga vitet paraprake nga tatimi në pronë, taksa për ushtrimin e veprimtarisë dhe lejet e ndërtimit.

Çështja 10 - Llogaritë e arkëtueshme -Prioritet i lartë

E gjetura Lista e debitorëve ndaj komunës, sipas të gjitha bazave, përbëjnë shumën e llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 1,186,000€. Pjesa më e madhe e këtyre llogarive kanë të bëjnë me tatimin në pronë prej 879,000€, dhe taksa për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit 180,000€ .

Rreziku Mos arkëtimi i të hyrave të ngarkuara mund të ndikojë në pamundësinë e Komunës për t'i përmbushur planet e shpenzimeve, dhe po ashtu, mund të rezultojë në vështirësi të mëtejshme në arkëtimin e të hyrave të ngarkuara.

Rekomandimi 11 Kryetari i Komunës duhet të inicioj një proces rivlerësimi, ku të gjitha llogaritë do të analizohen në kuptimin e vjetërsisë, shumave domethënëse, mundësive reale për inkasim dhe ushtrimin e masave administrative nëse ka nevojë.

4.6.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Komuna ka arritur të menaxhoj mirë me borxhet. Konkludimet tona të auditimit janë se trajtimi i borxheve dhe kontrollet ndaj tyre përgjithësisht funksionojnë mirë.

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2013 ishte në shumë prej 48,179€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2014. Arsyeja e mos pagesës me kohë të këtyre detyrimeve ishte mungesa e fondeve.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4.7 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) përbëhet vetëm nga një auditor, i cili njëherit është edhe drejtor i NJAB-it. Numri i stafit prej vetëm një auditori nuk është i mjaftueshëm për të mbështetur efektivisht punën e njësive të auditimit, marrë parasysh edhe buxhetin e komunës. Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 23/2009 Themelimi dhe funksionimi i njësive të AB në sektorin publik komuna duhet të ketë se paku tre auditor. Kjo njësi kishte planifikuar t'i kryej gjashtë auditime për 2013, ndërsa kishte kryer vetëm dy auditime. Auditimi ka mbuluar aktivitetet e dy viteve të fundit (2012 dhe 2013). Fushat në të cilat janë kryer auditime janë: Drejtoria e urbanizmit dhe menaxhimi i pasurisë. Cilësia e raporteve dhe kontributet e NJAB-i për vitin 2013 ishin mjaft të limituara për t'i ofruar menaxhmentit një pamje të plotë mbi nivelin e kontrolleve të brendshme të komunës.

Çështja 11 - Fokusi i punës së NJAB-së dhe rekomandimet e tyre-Prioriteti i lart

E gjetura Auditimi i brendshëm e ka adresuar vetëm një pjesë të planit të parashikuar dhe nuk i ka përfshirë rreziqet e njohura si në prokurim, të hyrat nga tatimet dhe taksat, subvencione dhe transfere dhe procedurat e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme.

Për punën faktike të ndërmarrë, nuk ishin bërë plane të veprimit nga menaxhmenti për t'i adresuar rekomandimet.

Rreziku Menaxhmenti nuk merr siguri të duhur nga AB mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme që rezultojnë në mos identifikimin e dobësive dhe në vazhdimin e praktikave joefikase që mund të rezultojnë me humbje financiare për Komunën.

Rekomandimi 12 Kryetari i Komunës duhet të punojë me NJAB-në për të zhvilluar një plan të bazuar në rreziqe i cili do të ofrojë siguri gjatë vitit 2014 mbi të gjitha fushat sinjifikante. Aty ku ka pasur rekomandime, menaxhmenti duhet në mënyrë aktive ta shqyrtojë një plan veprimi të zhvilluar për t'i adresuar rekomandimet e dakorduara brenda një afati kohor relevant. Po ashtu të shikoj mundësit për të shtuar stafin në NJAB.

Çështja 12 - Mos themelimi i Komiteti të Auditimit- Prioritet i lart

E gjetura Komuna nuk e ka të themeluar Komitetin e Auditimit për të lehtësuar implementimin e rekomandimeve të auditimit.

Rreziku Mungesa e një komiteti të auditimit zvogëlon nivelin e sfidës dhe mbështetjes për NJAB, duke përfshirë mbështetjen në implementimin e rekomandimeve të tyre.

Rekomandimi 13 Kryetari i Komunës duhet të sigurojë themelimin e një Komiteti të Auditimit i cili aplikon praktikë të mirë dhe të sigurojë se auditimi i brendshëm kryen punën në mënyrë cilësore dhe në pajtim me standardet dhe praktikat e mira.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomali, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
1.Pasqyrat Vjetore Financiare	Kryetari të siguroj që PVF të përgatiten në harmoni të plotë me rregulloren e Thesarit komuna të përgatisë planin e veprimit me staf llogaridhënës në fushat të rëndësishme më të madhe.		Po	
2.Rekomandimet e vitit paraprak	Të sigurohen që janë ndërmarr masa të nevojshme për t'i adresuar rekomandimet e ZAP.			Jo
3 Të hyrat	Të siguroj përmirësimin e proceseve buxhetore-ekzekutimin e buxhetit për Investimet kapitale dhe të hyrat e planifikuara të shqyrtohen në mënyrë kritike.	Po		
4. Kërkesat e raportimit	Të siguroj që janë vendosur prioritete mbi zhvillimin e vetë raportimeve-vetëvlerësimi.			Jo
5.Planifikimi i të hyrave	Të siguroj shumë burime informacioni për të aprovuar planin e të hyrave në mënyrë që të jetë i realizueshëm.		Po	
6.Tatimi në pronë dhe lejet e ndërtimit	Të siguroj një qasje më proaktive në mbledhjen e të hyrave përkatëse.			Jo
7.Regjistrimi i të hyrave	Regjistrimi i të hyrave në kode adekuate.	Po		

8.Certifikimi i pagesave-Pagesa të situacioneve jo adekuate.	Të siguroj që të forcohen kontrollet mbi pagesat-procesi i certifikimit të jetë në funksion parandaluese pagesave jo të rregullta.	Po		
9.Vonesa në ekzekutim të projekteve	Të respektohen kushtet e kontratës, në rastet e vonesave të pa arsyeshme.	po		
10.Shpërblim më kontratë OE të pa përgjegjshëm.	Të siguroj kontrollet gjate procesit te prokurimit të forcohen për të shmangur veprimet e tilla			Jo
11.Personeli	Të siguroj që dosjet e personelit të jenë të plota.	Po		
12.Subvencionet, mungesa e rregullores se brendshme	Te sigurohet që rregullorja e brendshme të aprovohet.			Jo
13.Menaxhimi i Pasurisë	Të siguroj që të formoj një komision për vlerësim të pasurive fikse më qëllim që të gjitha pasuritë të regjistrohen konform udhëzimi administrativ për menaxhimin e pasurive.			Jo
14.Auditimi i Brendshëm	Formimi i Komitetit të Auditimit të brendshëm.			Jo